



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KESHILLI I BASHKISË

Nr. 3310 Regj.

Ballsh, më 20.06.2022

VENDIM

Nr. 35 Datë 20/06/2022

“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare për Z.Barjam Zeqaj, banorë i fshatit Greshicë e Re, Njësia Administrative Greshicë, Bashkia Mallakastër, banesa (një katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit më datë 16.05.2022”.

Baza ligjore

- Ligji Nr.139/2015 date, 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore".
- Ligji Nr.107/2016 date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut".
- Ligji Nr.45, date 18.07.2019 "Per Mbrojtjen Civile".
- V.K.M. nr. 329, datel6.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat dhenies se ndihmes shteterore financiare permbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesit natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër për mbështetje financiare të familjes së Z.Barjam Zeqaj, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë e zjarrit të rënë më datë 16.05.2022.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të administruar nga ana e Bashkisë Mallakastër.

3. Miratimin e vlerës totale të dëmit nga ana e orendive shtëpiake prej **181.300 (njëqind e tetëdhjet e njëmijë e tetëqind) lekë** dëme në orendi shtëpiake.
4. Miratimin e vlerës së dëmit në masën prej **50 % 112.205 ,(njëqind e dymbëdhjetmijë e dyqindë e pesë lekë)**e vlerës totale prej **224.411(dyqind e njëzetë e katër mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) lekë**, dëme nga ana ndërtimore.
5. **Totali i vlerës (nga ana e orendive shtëpiake + 50 % nga ana ndërtimore) është 293.505 (dyqind e nëntëdhjetë e tremijë e pesëqind e pesë) lekë.**
6. Vlera e dëmit është përlllogaritur nga Komisioni i Vleresimit të dëmeve,të Bashkisë Mallakastër,ngritur me Urdhër nr.375 datë 11.12.2018 i ndryshuar, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.
7. Bazuar në ligjin 45,datë 18.07.2019 neni 41 “E drejta e kompesimit”,pika 2,në të cilën thuhet “Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësita,nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile.
8. Ndihma financiare për familjen e Z. Barjam Zeqaj përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat dhenies se ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore". Bazuar ne përputhje me çmimet aktuale mesatare për demtimet në orendi,mobilie dhe elektroshtëpiake të demtuara në objekte banimi.

KRYETAR

FITIM BARAJ

